

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar  
Advanced Financial Reporting

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data  
29.09.2018

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u></b>
1. Problemi 1	30	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	15	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Draft pasqyrat e pozitës financiare në vijim janë të California sh.a, Texas sh.a dhe New York sh.a me 31 mars 2018.

	California	Texas	New York
	€'000	€'000	€'000
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	430	530	420
Investimet në:			
Texas sh.a	276		
New York sh.a	20		
Prona investuese	<u>34</u>		
	760	530	420
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	30	40	50
Të arkëtueshmet tregtare	145	135	125
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	<u>105</u>	<u>95</u>	<u>85</u>
	<u>280</u>	<u>270</u>	<u>260</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,040</b>	<b>800</b>	<b>680</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<i>Ekuiteti</i>			
Aksionet e ekuitetit prej €1.00 secila	200	180	100
Përbërësit e tjerë të ekuitetit	170	130	110
Fitimet e mbajtura	<u>230</u>	<u>90</u>	<u>70</u>
<i>Total ekuiteti</i>	600	400	280
<i>Detyrimet</i>			
Detyrimet afatgjata	185	120	140
Detyrimet afatshkurtëra	255	280	260
<i>Total detyrimet</i>	<u>440</u>	<u>400</u>	<u>400</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,040</b>	<b>800</b>	<b>680</b>

### **Informatat në vijim janë relevante për përgaditjen e pasqyrave të grupit:**

- i) California sh.a bleu 80% të aksioneve të ekuitetit në Texas sh.a për një konsideratë në para. 80% e aksioneve është blerë si vijon:

<b>Data</b>	<b>Përqindja e blerë</b>	<b>Kosto e investimit €'000</b>
1 prill 2016	30%	96
1 prill 2017	50%	180

Vlera e drejtë e pasurive neto të Texas sh.a me 1 prill 2017 ishte €330,000. Në atë datë fitimet e mbajtura dhe përbërësit tjerë të ekuitetit të Texas sh.a ishin €50,000 dhe €90,000 respektivisht. Vlera e drejtë më e larte e pasurive neto ka të bëjë më tokën e pazhvlerësueshme.

California sh.a nuk kishte ndikim domethënës në interesin prej 30% në ekuitetin e Texas sh.a. Vlera e drejtë e interesit prej 30% në ekuitetin e Texas sh.a dhe interesave jo-kontrollues me 1 prill 2017 ishin €108,000 dhe €72,000 respektivisht.

Interesi prej 30% në ekuitetin e Texas sh.a është bartur sipas vlerës së drejtë deri me 1 prill 2017 ku më pas është paraqitur sipas koston dhe është regjistruar sipas koston që atëhere.

- ii) California sh.a bleu 70% të aksioneve të ekuitetit të New York sh.a-së me 1 prill 2015 për një këmbim të aksioneve prej 3 aksioneve në California sh.a për 4 aksioneve në New York sh.a. Vlera e drejtë e pasurive neto të New York sh.a me 1 prill 2015 ishte €190,000. Fitimet e saj të mbajtura dhe komponentët tjerë të ekuitetit në atë datë ishin €40,000 dhe €70,000 respektivisht. Deficiti në vlerën e drejtë të pasurive neto ka të bëjë me një zë të fabrikës dhe kishte jetë të mbetur të përdorimit prej katër (4) viteve me 1 prill 2015.

Çmimi i tregut për aksion i aksioneve të ekuitetit të California sh.a dhe aksioneve të ekuitetit të New York sh.a me 1 prill 2015 ishte €2.40 dhe €1.60 respektivisht. Vlera e drejtë e interesave jo-kontrollues me 1 prill 2015 ishte €48,000.

- iii) Me 31 mars 2018, California sh.a bleu edhe 10% të aksioneve të ekuitetit të New York sh.a-së për një konsideratë në para prej €20,000. California sh.a e ka regjistruar drejtë konsideratën në para në pasqyrën e mësipërme të pozitës financiare.
- iv) Texas sh.a dhe New York sh.a nuk kanë emetuar aksione tjera prej blerjes së tyre nga California sh.a. Për më tepër, korigjimet e vlerave të drejta të diskutuara në (i) dhe (ii) më lartë nuk janë përfshirë në pasqyrat e mësipërme të pozitës financiare.

- v) Investimet në Texas sh.a dhe New York sh.a janë klasifikuar si pasuri financiare nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse në pajtim me SNRF 9 '*Instrumentet Financiare*'. Vlera e drejtë e investimeve në Texas sh.a dhe New York sh.a nuk ka ndryshuar shumë që nga data e blerjes. Prandaj janë të regjistruara në pasqyrën e mësipërme të pozitës financiare sipas kostove përkatëse.
- vi) Është politikë e grupit të vlerësoj interesat jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë të pasurive neto në blerje.
- vii) California sh.a ka një politikë të kontabilizimit të pronës investuese sipas vlerës së drejtë. Vlera e saj e drejtë me 31 mars 2018 ishte €37,000.
- viii) Me 31 mars 2018, zëri i mirë në Texas sh.a është dëmtuar për €10,000 përderisa zëri i mirë në New York sh.a nuk është dëmtuar.

**Kërkohet:**

**Përgaditeni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit California sh.a me 31 mars 2018 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (30 pikë)**

**1.****Grupi California sh.a****Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare me 31 mars 2018**

€'000

**Pasuritë***Pasuritë jo-qarkulluese*

Prona, fabrika dhe paisjet 430+530+420 - 10L11+15L12 1,385

Zëri i mirë L11 20

Prona investuese 37

1,442*Pasuritë qarkulluese*

Stoqet 30+40+50 120

Të arkëtueshmet tregtare 145+135+125 405

Paraja dhe ekuivalentet e parasë 105+95+85 285

810**Total pasuritë 2,252****Ekuiteti dhe detyrimet***Ekuiteti*

Aksionet e ekuitetit prej €1.00 secila+52.5 L14 252.5

Përbërësit e tjerë të ekuitetit L15 320

Fitimet e mbajtura L12 304.5

877

Interesat jo-kontrollues L16 135

*Total ekuiteti 1,012**Detyrimet*

Detyrimet afatgjata 185+120+140 445

Detyrimet afatshkurtëra 255+280+260 795

*Total detyrimet 1,240***Total ekuiteti dhe detyrimet 2,252****Llogaritjet****L11 - Zëri i mirë****Texas sh.a**

€'000

€'000

Konsiderata: 30% (VD) 108

50% 180

VD e IJK-së në blerje 72

360

VD e PN në blerje:

Kapitali aksionar 180

Përbërësit e tjerë të ekuitetit 90

Fitimet e mbajtura 50

VD korigjim - toka (shif. bal) 10

(330)

Zëri i mirë 30

Dëmtimi (10)

	€'000	20 €'000
<b>New York sh.a</b>		
Konsiderata:		
Këmbimi i aksioneve $\frac{3}{4}$ x 70 aksione x €2.4		126
VD e IJK-së në blerje		<u>48</u>
		174
VD e PN ne blerje:		
Kapitali aksionar	100	
Përbërësit e tjerë të ekuitetit	70	
Fitimet e mbajtura	40	
VD korigjim - fabrika (shif. bal)	<u>(20)</u>	
		(190)
<b>Zëri i mirë negativ</b>		<b>(16)</b>
VD korigjim neto 10,000 - 20,000 = -10,000		

#### **L12 - Fitimet e mbajtura**

	€000
Sipas pyetjes - California sh.a	230
Pjesa e grupit në:	
Texas sh.a 80% x (90 - 50)	32
New York sh.a 70% x (70 - 40 +15 shënim më poshtë)	31.5
Dëmtimi i zërit të mirë 80% x 10	(8)
Zëri i mirë negativ në New York sh.a <b>L11</b>	16
Fitimi në VD të pronës investuese (37 - 34)	<u>3</u>
	<b>304.5</b>

Zhvlerësimi i tepërt ne VD të korigjuar të fabrikës  $\frac{3}{4}$  x 20 = 15,000

#### **L13 - Levizjet e ekuitetit - 10% pronësi shtesë të aksioneve në New York sh.a**

	€'000
VD e IJK-së në blerje (30% = 72,000 atehere 20% = 48,000)	48
Pjesa e IJK-së në rezervat e New York sh.a pas blerjes:	
Përbërësit e tjerë të ekuitetit 30% x (110 - 70)	12
Fitimet e mbajtura 30% x 45 <b>L12</b>	<u>13.5</u>
	73.5
Zvogëlimi i IJK-së 10/30 x 73.5	24.5
Konsiderata e paguar	<u>(20)</u>
<b>Levizjet pozitive në ekuitet</b>	<b>4.5</b>

#### **L14 - Këmbimi i aksioneve**

	€'000
Kapitali aksionar $\frac{3}{4}$ x 70 aksione x €1	52.5
Premia e aksioneve $\frac{3}{4}$ x 70 aksione x €1.4	73.5

**L15 - Përbërësit e tjerë të ekuitetit**

	€'000
Sipas pyetjes - California sh.a	170
Pjesa e grupit në:	
Texas sh.a 80% x (130 - 90)	32
New York sh.a 70% x 40 <b>L13</b>	28
Fitimi në VD prej 30% pronësi 108 - 96	12
Premia e aksioneve në këmbimin e aksioneve <b>L14</b>	73.5
Levizjet pozitive në ekuitet <b>L13</b>	<u>4.5</u>
	<b>320</b>

**L16 - Interesat jo-kontrollues**

	€'000	€'000
Në New York sh.a 20/30 x 73.5 <b>L13</b>		49
Në Texas sh.a		
VD në blerje <b>L11</b>	72	
Pjesa e rezervave pas blerjes:		
TTGJ 20% x 40 <b>L15</b>	8	
FM 20% x 40 <b>L12</b>	8	
Dëmtimi i zërit të mirë 20% x 10	<u>(2)</u>	
		<u>86</u>
Total		<b>135</b>



## Problemi 2

Me 1 janar 2017, Florida sh.a, një kompani e listuar, kishte 10 milion €1 aksione të zakonshme të emetuara. Me 1 mars 2017, Florida sh.a emetoi nga fitimet e mbajtura 1 aksion bonus për çdo 2 aksione. Me 1 gusht 2017, Florida sh.a emetoi 6 milion €1 aksione të zakonshme me çmimin e plotë të tregut prej €4.10 për aksion.

Fitimet e Florida sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 ishin €7.6 milion. Fitimi i thjeshtë për aksion për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 ishte 45 cent.

Me 1 janar 2017, aksionarët e zakonshme të Florida sh.a mbanin opzione për të blerë 2 milion €1 aksione të zakonshme me €4.20 për aksion. Opcionet janë të ushtrueshme nga 31 dhjetor 2018 deri me 31 dhjetor 2019. Nuk janë emetuar opzione të tjera gjatë vitit. Çmimi mesatar i tregut të një €1 aksioni të zakonshëm të Florida sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 ishte €5.00.

### Kërkohet:

- i) Llogarite fitimin e thjeshtë për aksion që duhet të raportohet në pasqyrat financiare të Florida sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, duke përfshirë shifrat krahasuese, në pajtim me kërkesat e SNK 33 *Fitimi për aksion*. (4 pikë)
- ii) Llogarite fitimin e tretur për aksion për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017, në pajtim me kërkesat e SNK 33 *Fitimi për aksion*. (3 pikë)
- iii) Llogarite koeficientin  $C/F$  dhe diskuto rëndësinë e tij për investitorët. (3 pikë)

## Zgjidhja e problemit 2

### 2.

#### (i) FPA e thjeshtë:

Fitimi i atribuar aksionarve të zakonshëm	€7,600,000
Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të emetuara gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2017: $(10,000,000 \times 7/12) + (16,000,000 \times 5/12) + 5,000,000$ (bonus)	17,500,000
FPA e thjeshtë	<b>43.4 cent</b>
FPA e thjeshtë për v/p me 31 dhjetor 2016 (riparaqitur) $45 \text{ cent} \times 2/3$	<b>30 cent</b>

#### (ii) FPA e tretur:

Fitimi i atribuar aksionarve të zakonshëm	€7,600,000
Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të emetuara gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2017 nga pjesa (i):	17,500,000
Aksionet të mbajtura në opcion	2,000,000
Aksionet që do të ishin emetuar me çmim mesatar të tregut $(2,000,000 \times 4.20/5.00)$	(1,680,000)
Aksione efektivisht të emetuara pa konsideratë dhe tretese	<u>320,000</u>
Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të emetuara dhe aksionet e zakonshme potenciale gjatë vitit të përfunduar me 30 dhjetor 2017	17,820,000
	<b>42.6 cent</b>

#### (iii) Koeficienti $C/F = €5.00/€43.4 = 11.5$

Llogaritja e koeficientit  $C/F$  jep një shifër e cila është e dobishme për vlerësimin e rrezikut relativ të një investimi. Koeficienti  $C/F$  i ulët tregon rrezik më të lartë për investitorët. Koeficienti i lartë  $C/F$  tregon se kompania është e shëndoshë dhe ka potencial të lartë për rritje.

### Problemi 3

- a) Kompania Montana sh.a bleu një makinë në vitin 2016. Në fillim, jeta e pritur e përdorimit të makinerisë ishte përcaktuar të jetë 10 vite. Më pas, në vitin 2017, auditorët e jashtëm të kompanisë vërejtën që jeta e vertetë e përdorimit e pritur e makinerisë ishte vetëm 5 vite. Jeta e përdorimit prej 10 viteve ishte vlerësuar si e tillë për qëllim të mashtrimit. Kompania rishikoi jetën e përdorimit të makinerisë dhe e përcaktoi atë në 5 vite në vitin 2017.

**Kërkohe:**

Diskuto nëse ndryshimet në jetën e përdorimit të makinerisë trajtohen nga "Ndryshimet në Politikën e Kontabilitetit", "Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël" apo "Gabimet" sipas SNK 8 *Politikën e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.* (4 pikë)

- b) Identifiko dhe shpjego nëse pasuritë në vijim janë "Pasuri Investuese" sipas SNK 40 *Prona Investuese:*

- i) Toka e mbajtur për rritje në vlerën kapitale në afat të gjatë.
- ii) Një ndërtesë në pronësi të një kompanie dhe e lëshuar me qira nën një lizing operacional
- iii) Pronat e zhvilluara në emër të palëve të treta
- iv) Një pronë që i është lëshuar me qira një pale tjetër nën lizing financiar
- v) Një hotel në pronësi dhe e menaxhuar nga vetë kompania. (10 pikë)

- c) Një kompani bleu një pronë investuese në Nevada ku tregu i patundshmerive është aktiv për zhvillim dhe mati vlerën e drejtë në €15 milion. Pasi që përfundoi zhvillimi, kompania pretendoi që nuk mund ta përcaktoj vlerën e drejtë të pronës edhe pse tregu është akoma aktiv dhe dëshiron që të ndërroj vlerësimin në modelin e kostos.

**Kërkohe:**

Shpjego se pse vendimi i kompanisë nuk lejohet nga SNK 40 *Prona Investuese.*

(6 pikë)

(Total: 20 pikë)

### Zgjidhja e problemit 3

a) Ndryshimet në jeten e pritur të një pasurie të zhvlerësueshme trajtohet nga “Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël” por pasiqë transaksioni ka të bëjë me mashtrim, atehere në këtë rast trajtohet nga “Gabimet” sipas SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet - gabimet e viteve të mehershme.*

#### b)

- i) Po, sepse tregon që toka nuk është blerë për shitje në afat të shkurtër.
- ii) Po, sepse është në pronësi nga kompania. Lejimi me qira nën lizing operacional nuk mund të konsiderohet shitje e pasurisë.
- iii) Jo, sepse pronari është vetë pala e tretë.
- iv) Jo, sepse është dhënë me lizing financiar.
- v) Jo, sepse një hotel i menaxhuar nga vete pronari është pronë e zenë nga pronari e jo pronë investuese.

#### c)

Ekziston një supozim i kundërshtueshëm se një entitet mund të matë vlerën e drejtë të një prone investuese në bazë të vazhdueshme. Nëse supozohet se kompania nuk mund të matë vlerën e drejtë me besueshmëri, atehere kompania mund të përdor modelin e kostos. Por, ky argument nuk mund të pranohet pasi që prona është blerë në Nevada ku tregu i patundshmerive është aktiv.

#### **Problemi 4**

SNK 10 *Ngjarjet pas peridhes raportuese* jep udhëzime për trajtimin e ngjarjeve të cilat ndodhin pas periudhes raportuese por të cilat mund të kenë implikim për pasqyrat financiare deri me datën e raportimit. Bën dallimin ndërmjet ngjarjeve korigjuese dhe jo-korigjuese.

Colorado sh.a është në proces të përfundimit të pasqyrave të saj financiare për vitin e përfunduar me 31 mars 2018. Draft pasqyrat financiare janë përfunduar me 14 prill 2018, dhe auditimi i tyre është në proces. Pasqyrat financiare pritet të aprovohen nga bordi i drejtorve me 15 maj 2018, dhe publikuar me 20 maj 2018. Çështjet në vijim janë nxjerr në pah gjatë auditimit dhe kërkohet këshilla e juaj. Nuk është bërë ende asnjë korigjim për asnjë nga të mëposhtmet.

- (i) Stoqet në fund me 31 mars 2018 përfshinin 100 artikuj me vlerë bartese prej €5,000 secili. Rregulloret e reja të sigurisë janë bërë publike me 5 prill 2018 të cilat hyjnë në fuqi menjëherë. Artikujt e stoqeve nuk janë në pajtueshmëri me këto rregullore. Si rezultat, vlera neto e realizueshme e stoqeve është vetëm €4,500 për secilën.
- (ii) Një investim në një instrument ekuiteti që nuk është i kuotuar është mbajtur nga Colorado sh.a me 31 mars 2018 me një shumë prej €3.5 milion. Kjo ishte vlera e drejtë me 30 shtator 2017, datës së fundit të raportimit. Për shkak të mungesës së vlerësuesve profesionist, vlera e drejtë e re nuk ishte në dispozicion deri me 15 prill 2018. Në këtë datë, vlerësuesi dha një vlerësim të vlerës së drejtë prej €2.8 milion.
- (iii) Colorado sh.a ishte paditur me 31 mars 2018. Në atë datë rasti vetëm është degjuar, por gjykimi ka përfunduar me 20 prill 2018. Rezultati ishte që Colorado sh.a është fajtor për dëmet që kushtojnë në total €3.1 milion. Me 21 prill 2018, Colorado sh. Dergoi një kërkesë të siguruesi i tij dhe me 28 prill 2018, është njoftuar se siguruesi do të mbulojë €2.6 milion të humbjes.
- (iv) Me 30 mars 2018, Colorado sh.a pagoi €500 për një tiketë të llotarisë për të mbështetur një fond lokal të bamirësisë. Me 3 prill 2018, kompania është njoftuar se ka fituar shpërblimin prej €100,000. Numrat janë luajtur me 31 mars 2018.

#### **Kërkohet:**

- a) **Diskuto konceptet e ngjarjeve “korigjuese” dhe “jo-korigjuese” siç janë përkufizuar nga SNK 10 *Ngjarjet pas peridhes raportuese*, dhe shpjego trajtimin në kontabilitet dhe shpalosjet e kërkuara në secilin rast më sipër. (8 pikë)**
- b) **Për secilin rast më sipër (i) deri (iv), përgadit një shënim të shkurtë duke këshilluar për trajtimin në kontabilitet dhe/ose shpalosjet e kërkuara si rezultat i ngjarjes(ve) pas periudhes raportuese. (12 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 4

(a)

Është normale që pasqyrat financiare të marrin kohë pas përfundimit të vitit për tu finalizuar, audituar dhe aprovuar për publikim nga bordi i drejtorve. Ngjarjet pas periudhës raportuese janë ato ngjarje, të favorshme dhe të pafavorshme, që ndodhin ndërmjet datës raportuese dhe datës kur pasqyrat financiare autorizohen për publikim.

### Ngjarje korigjuese:

Një ngjarje korigjuese është një ngjarje e cila jep dëshmi të tjera të një gjendje që ka ekzistuar në datën e raportimit. Një entitet duhet ti korigjoj shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për periudhën që sapo ka përfunduar për të reflektuar ngjarjet korigjuese pas periudhës raportuese.

### Ngjarje jo-korigjuese:

Një entitet nuk duhet të korigjoj shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarjet jo-korigjuese pas periudhës raportuese. Në këtë rast, nuk ka ekzistuar gjendja në datën e raportimit, andaj nuk duhet të bëhen korigjime. Shpalosjet duhet të bëhen në pasqyrat financiare të ngjarjeve signifikante jo-korigjuese pas periudhës së raportimit. Nëse ngjarja jo-korigjuese nënkupton që parimi i vazhdimësisë nuk vlen më për entitetin, ngjarja duhet të trajtohet si një ngjarje korigjuese, dhe pasqyrat financiare nuk duhet të përgaditen sipas parimit të vazhdimësisë.

(b)

- (i) Duket se ngjarja që ka shkaktuar humbjen ka ndodhur pas datës së raportimit. Nuk ka ekzistuar kushti në datën e raportimit. Sikur t'i kishim shitur mallrat në datën e raportimit do të kishim pasur çmimin e plotë për to. Andaj kjo është një ngjarje jo-korigjuese. Nëse humbja është materiale, shpalosja e ngjarjes duhet të bëhet në shënime të pasqyrave financiare.
- (ii) Përderisa nuk është e qartë nëse ndonjë ngjarje specifike ndërmjet datës 31 mars dhe 15 prill 2018 ka shkaktuar rënien në vlerën e investimit, duhet të supozohet që investimi në fakt ka humbur vlerën para 31 mars 2018, dhe vlerësimi pas kësaj datë vetëm ka dhënë dëshmi për këtë. Andaj, pranimi i vlerësimit është një ngjarje korigjuese dhe investimi duhet të zvogëlohet në datën e raportimit.
- (iii) Detyrimi ka ekzistuar në datën e raportimit, por konfirmimi i shumës është pranuar me 20 prill 2018. Kjo është një ngjarje korigjuese, dhe trajtimi i këtij zëri në pasqyrat financiare (duke supozuar se nuk ka pagim) duhet të korigjohet për të reflektuar informatën e marrë më pas. Si rrjedhojë, provizioni duhet të ndahet për tërë shumë. Dergimi i kërkesës tek siguruesi ka ndodhur pas periudhës raportuese, andaj nuk duhet të mirret parasysh me 31 mars 2018. Pasi që konfirmimi i suksesit të kërkesës është pranuar para datës së aprovimit, kjo duhet të shpaloset në shënime.

- (iv) Çmimi në fakt është fituar para datës së raportimit. Andaj pasqyrat financiare duhet ta reflektojnë këtë fakt edhe pse njoftimi ka arritur me 3 prill. Kjo është një ngjarje korigjuese.

## Problemi 5

- a) Oklahoma sh.a është një kompani e madhe prodhuese e tekstilit. Sa here që është e mundur i strukturon operacionet e saj në atë mënyrë që të përfitoj ndonjë asistencë financiare në dispozicion nga autoritetet nacionale dhe regjionale.

Gjatë vitit, është blerë një paisje për punë të rënda në operacionet kryesore të prodhimit të Oklahoma sh.a për €12 milion me 1 prill 2016. Paisja pritet të përdoret për 10 vite, me zero vlerë të mbetur. Oklahoma sh.a paraprakisht aplikoj për një grant qeveritar me 1 janar 2016, duke i përmbushur të gjitha kriteret e nevojshme për fitimin e grantit. Me 1 shkurt 2016, granti është dhënë për 40% të kostos së paisjes dhe paraja është pranuar me 1 korrik 2016. Kushtet e lidhura me grantin janë të mbahen punëtorët, dhe nese nuk përmbushet, atehere granti bëhet i ripagueshem, apo pjesërisht i pagueshëm.

Oklahoma sh.a priti se do t'i përmbush kushtet në kohen kur aplokoj për grant. Por, për shkak të vështëresive ekonomike, mos vazhdimi i kontratave të disa punëtorve me 31 dhjetor 2017 rezultoi me ripagim të 10% të grantit që është marrë në fillim dhe kjo shumë u bë e ri-pagueshme. Ri-pagimi është bërë me 1 shkurt 2018. Oklahoma sh.a kontabilizoi grantin si një zvogëlim të shumës bartëse të pasurisë.

### **Kërkohet:**

**Shpjego, me llogaritje të përshtatshme, trajtimin në kontabilitet të ngjarjes më lartë në pasqyrat financiare të Oklahoma sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 në pajtim me SNK 20 Kontabilizimi i granteve qeveritare dhe shpalosja e asistencës qeveritare.** (6 pikë)

- b) Marrëdhëniet më palët e ndërlidhura janë një veçori e shpeshtë e jeytës komerciale. Objektiv i SNK 24 *Shënimet shpjeguese të palëve të ndërlidhura* është që të sigurohet se pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e nevojshme për t'i vetëdijësuar përdoruesit për mundësinë që pasqyrat financiare mund të jenë afekruar nga ekzistenca e palëve të ndërlidhura.

### **Kërkohet:**

**Shpjego DY rëndësi të shpalosjeve në pasqyrat financiare të marrëdhënieve dhe transaksioneve me palët e ndërlidhura.** (4 pikë)



- c) Kansas sh.a, bleu 80% të aksioneve të zakonshme në Nebraska sh.a me 1 janar 2016. Pasuritë e paprekshme të Nebraska sh.a përfshijnë €9 milion të shpenzimeve të trajmit dhe marketingut që ndodhën gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2017. Drejtorët e Nebraska sh.a besojnë që këto duhet të kapitalizohen pasi që kanë të bëjnë me periudhen e fillimit të biznesit në Kosovë, dhe kanë për qëllim të amortizojnë saldon përgjatë 5 viteve duke filluar me 1 janar 2018.

Me 1 korrik 2017, Kansas sh.a bleu një listë të klientëve nga likuidatori i një konkurenti. Çmimi që u pagua ishte €4 milion dhe është bazuar në jetëgjatësinë e listes prej 2 viteve. Me 31 dhjetor 2017, drejtori financiar i Kansas sh.a pranoi një raport lidhur me vlerën e listës nga një firmë e pavarur e vlerësuesve. Firma e ka vlerësuar listen në €5 milion dhe vlerëson në total jetë të përdorimit prej 5 viteve. Lista e klientëve është aktualisht e përfshirë në pasuritë e paprekshme sipas vlerës bartëse prej €4 milion por drejtori financiar dëshiron që lista të rivlerësohet në shumën më të lartë.

**Kërkohet:**

**Rekomando trajtimin në kontabilitet të zërave më lartë në pasqyrat e konsoliduar të të ardhurave të grupit Kansas sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 në pajtim me SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara. (6 pikë)**

- d) Louisiana sh.a bleu një obligacion 10 vjeçar me 1 gusht 2017 me kosto prej €45 milion. Obligacioni bart një kupon me interes prej €5 milion që paguhet në baza vjetore në fund të vitit, dhe kthimi efektiv deri në maturitet ishte 12% në datën e blerjes. Louisiana sh.a është duke e mbajtur obligacionin si një investim spekulativ, pasi që pret se vlera e drejtë e tij do të rritet dhe më pas do ta shes obligacionin dhe të fitoj në afat të shkurtë apo aat të mesëm. Me 31 korrik 2018, në datën e saj të raportimit, vlera e drejtë e obligacionit ka rënë në €43 milion. Pagesa e interesit është pranuar sipas planit të pagesës.

**Kërkohet:**

**Këshillo Louisiana sh.a për trajtimin e instrumentit financiar mësipër në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 korrik 2018 në pajtim me SNRF 9 Instrumentet Financiare. (4 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 5

- a) Granti është njohur në pasqyrat financiare me 1 shkurt 2016 si e hyrë e shtyrë në atë datë. I është kredituar vlerës së pasurisë me 1 prill 2016, datën kur pasuria është njohur fillimisht.

Vlera bartëse e pasurisë llogaritet si në vijim:

	€
Vlera e pasurisë në njohjen fillestare (1 prill 2016)	12,000,000
Granti (€12m x 40%) – kredituar tek pasuria me 1 prill 2016	<u>(4,800,000)</u>
	7,200,000
Zhvlerësimi 2016 (€7.2m/10 vite x 9/12)	<u>(540,000)</u>
31 dhjetor 2016	6,660,000
Zhvlerësimi 2017 (€7.2m/10 vite)	<u>(720,000)</u>
	5,940,000
Ripagimi i grantit (€4.8m x 10%)	480,000
Zhvlerësimi shtesë (480,000 x 1¾/10 vite)	<u>(84,000)</u>
31 dhjetor 2017	6,336,000

Hyrja e dyfishtë është:

	€	€
D Pasuria (480,000 – 84,000)	396,000	
D Fitimi ose humbja	84,000	
K Granti i ripagueshëm detyrim		480,000

## b) Rëndësia e shënimeve shpjeguese të palëve të ndërlidhura

- Investitorët investojnë në një biznes duke supozuar se ai biznes ka për qëllim maksimizimin e fitimeve të saj për përfitim të aksionarve të saj. Kjo nënkupton që të gjitha transaksionet janë duarlibër ndërmjet palëve të vullnetshme dhe të informuara. Ekzistenca e paleve të ndërlidhura mund të i inkurajoj drejtorët që të marrin vendime për përfitim të një entiteti tjetër në dëm të aksionarve të tyre. Kjo mund të bëhet vazhdimisht duke i shitur mallra dhe dhënë shërbime më çmim të ulët palëve të ndërlidhura, ose duke blerë mallra dhe shërbime më një çmim më të lartë se ai i tregut. Mund gjithashtu të ndodhë kur drejtorët zgjedhin që të mos konkurojnë me palët e ndërlidhura, ose duke ofruar garancion apo kolateral për kredinë e palës së ndërlidhur.
- Shënimet shpjeguese janë veçanërisht të rëndësishme kur biznesi është duke u shitur. Mund që të jetë duke pranuar shumë furnizime, shërbime apo ndihmë të përgjithshme nga familja apo grup i kompanive. Kur kompania të shitet këto përfitime mund të ndërpriten..

- Transaksionet më palë të ndërlidhura nuk janë kunder ligjore, e as nuk janë domosdoshmërisht gjë e keqe. Megjithatë aksionarët dhe investitorët potencial kanë nevojë të informohen për transaksione materiale me palët e ndërlidhura me qëllim që të marrin vendime duke qenë të informuar.

- c) SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara thotë që kostot e fillimit të biznesit, trajnimit dhe promovimit duhet të shlyhen si shpenzim sapo të ndodhin dhe nuk krijohet asnjë pasuri e patrupëzuar që mund të njihet (përfitimet nuk mund të dallohen qartazi nga zeri i mirë i gjeneruar së brendshmi, i cili nuk njihet). Fitimet e mbajtura të Nebraska sh.a-së do të zvogëlohen për €9 milion (që do të ketë rezultat të zvogëlimit të pjesës së fitimeve të IJK-së) dhe pasuritë e patrupëzuara të Nebraska sh.a gjithashtu do të zvogëlohen për €9 milion.

Lista e klientëve duket se i përmbush kërkesat e SNK 38, pasi që është një pasuri jo-monetare e identifikueshme pa substancë fizike. Lista është e identifikueshme pasi që është blerë nga një palë e tretë. Probabiliteti i përfitimeve të ardhshme ekonomike është gjithmonë i supozuar nga një blerje e tillë nga pala e tretë. Kansas sh.a pra ka adoptuar trajtimin adekuat në kontabilitet duke e kapitalizuar listen sipas kostos prej €4 milion. Por, lista duhet të amortizohet përgjatë jetës së saj të përdorimit që e kishte në fillim prej 2 viteve.

Andaj amortizimi do të jetë  $4/2 \times 6/12 = €1$ .

Rivlerësimi është bërë në fund të vitit dhe nuk ka efekt në fund të këtij viti.

Hyrja e dyfishhtë që duhet të bëhet në librat e Kansas sh.a

	€	€
D Shpenzimet administrative dhe të shpërndarjes (PA)	1m	
K Pasuritë e paprekshme (PPF)		1m

- d)
- Pasi që obligacioni nuk do të mbahet deri në maturitet dështon që të kaloj testin e "Modelit të Biznesit" që kërkohet nga SNRF 9 Instrumentet Financiare.
  - Kjo do të thotë që metoda e kostos së amortizuar nuk mund të përdoret, dhe metoda e vlerës së drejtë duhet të përdoret në vend të kësaj.
  - Kjo rezulton me një humbje prej €2 milion nga vlera e drejtë, dhe vlerë bartëse prej €43 milion.
  - Interesi i arkëtuar prej €5 milion njihet si fitim ose humbje. Kjo rezulton në një fitim net prej €3 milion në fitim ose humbje.